




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM



Nr. 29, datë 20.1.2016

PËR

**SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHATIT DHËRMI
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN
E SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e rregullores "Për administrimin e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe të Zonës së Mbrojtur përreth", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Ministria e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I KULTURËS

MIRELA KUMBARO FURXHI

Kelso
Beri
25.01.2016
X

RREGULLORE
“PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE TË FSHTATIT DHËRMI DHE
ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH”

Neni 1
Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.
2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:
 - a) administrimi i Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj;
 - b) mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave historiko-kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi.
3. Kjo rregullore përcakton edhe mënyrat e bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore të qytetit të Himarës për administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi.

Neni 2
Struktura e hapësirës urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e fshatit Dhërmi për vlerat e saj historiko-kulturore dhe si pjesë e trashëgimisë kulturore i nënshtrohet ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, si dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore në mbrojtje e fshatit Dhërmi përbëhet nga:
 - a) Qendra Historike;
 - b) Zona e Mbrojtur rreth saj.
3. Kufijtë e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj paraqiten në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.
4. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë së Himarës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 3

Qendra Historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra Historike është pjesa më me vlera urbanistiko-arkitektonike e fshatit Dhërmi. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore, si ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik tradicional i cili është pjesë e Qendrës Historike. Qendra Historike përbëhet edhe nga zonat e gjelbra të përfshira brenda saj.

2. Qendra Historike e fshatit Dhërmi përbëhet nga dy zona:

- a) Zona I e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës kombëtare në hyrje të fshatit Dhërmi;
- b) Zona II e cila përfshin pjesën e Dhërmiut të vjetër dhe shtrihet në pjesën verilindore deri mbi rrënojat e Manastirit të Panaisë me Kishën e Fjetjes së Shën Mërisë dhe në jugperëndim zbret deri poshtë rrugës kombëtare.

Në këto zona përfshihen një numër i konsiderueshëm banesash me një tipologji të larmishme dhe një rrjet rrugor të kalldrëmuar, herë-herë të formuluar me shkallëzime në pjerrësi të terrenit.

3. Kufijtë e Qendrës Historike paraqiten në koordinata gjeografike si edhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Ndërhyrjet e lejuara në Qendrën Historike

1. Ndërhyrjet restauruese dhe rigjallëruese në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive do të kenë si qëllim kthimin e fshatit Dhërmi në një qendër të rëndësishme turistike të karakterit rural e familjar. Për të realizuar këtë qëllim për Qendrën Historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rigjallëruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitekturore të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

- a) Ndërhyrjet sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes në Qendrën Historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.

- b) Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.
- c) Studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të saj, lidhur me qëndrimin ndaj ndërtimeve, që me volumet dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe unitetin kompozicional të Qendrës Historike.
- ç) Studime të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.
- d) Ndërhyrjet rehabilituese, konservuese ose restaurimet integruese, për ndërtimet që janë në gjendje rrënoje për të penguar degradimin e mëtejshëm të tyre. Kur rrënojat ruhen dhe paraqesin vlera me rëndësi arkitektonike, kompozicionale dhe tipologji të veçanta, por cenojnë dukshëm njësinë e ansambleve, brenda të cilave përfshihen, mund të kryhet rikonstruksioni në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetralë) me objektiv primar ruajtjen sa të jetë e mundur të karakteristikave origjinale të dukshme, të jashtme dhe të brendshme, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit. Në rastet kur rrënojat janë nën 3m ato duhet të konsolidohen dhe, në raste të veçanta, mund të ringrihen duke zbatuar parimet e mësipërme.
Projektet për ndërhyrjet në këto lloj objektesh do të shqyrtohen dhe do të miratohen rast pas rasti në Këshillin Shkencor dhe Këshillin Kombëtar të Restaurimeve.
- dh) Në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, rikonstruksioni mund të kryhet mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.
- e) Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje, si trajtimi i tyre me materiale të traditës dhe zonës, dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

3. Në Qendrën Historike ndalohen ndërtimet e reja me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe rikonstruksioneve të përmendura në pikat më sipër.

4. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Neni 5

Zona e Mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e Mbrojtur shtrihet në pjesën më të madhe në anën juglindore të Qendrës Historike. Ajo përbëhet nga:

- a) Nënzona I e mbrojtur,
- b) Nënzona II e mbrojtur (Zonë e Gjellbër).

2. Nënzona I e mbrojtur përmban banesa me vlera arkitektonike dhe rrjetin rrugor karakteristik të fshatit, me të cilat plotësohen vlerat e Qendrës Historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të planifikuara për ndërtime të reja.

3. Nënzona II e mbrojtur është një zonë me një gjellbërime që formohet nga drurë të ndryshëm, si me ullinj, rrepër dhe bimësi të ndryshme që ndan edhe dy pjesët e Qendrës Historike dhe përbën pjesën më të madhe të zonës së gjellbër të fshatit.

4. Kufijtë e Zonës së Mbrojtur paraqiten në koordinatat gjeografike, si dhe në hartën e zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndërhryjet në Zonën e Mbrojtur

1. Ndërhryjet që lejohen në Zonën e Mbrojtur janë si më poshtë:

- a) Ndërhryjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues përveç rikonstruksionit të tij.
- b) Kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.
- c) Ruajtja e rrjetit rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik.
- ç) Ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale.

3. Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 2 (dy) – 6.5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën më të madhe të terrenit.

4. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.

5. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe më pas procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Neni 7

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

1. Monumentet e Kulturës në fshatin Dhërmi, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore, ndahen në dy kategori:

- a) Monumente të kategorisë I;
- b) Monumente të kategorisë II.

2. Ato ndodhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur ose në pjesët e tjera të fshatit. Kjo ndarje sipas vlerave pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat e shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Neni 8

Monumentet e kategorisë I

1. Monumentet e kategorisë I janë objektet dhe ndërtimet me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale të fshatit Dhërmi.

2. Monumentet e kategorisë I, me shkallë të mirë autenticiteti, ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse janë pjesë organike e monumentit dhe si të tilla i nënshtrohen të njëjtit trajtim.

3. Monumentet e kategorisë I, ruhen në Qendrën Historike, në Zonën e Mbrojtur rreth saj dhe në pjesën tjetër të fshatit.

4. Në monumentet e kategorisë I, kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme dhe të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale nuk mund të ndryshohet, me përjashtim të vendosjes së nyjes higjieno-sanitare kur është e domosdoshme dhe nuk cenon vlerat për të cilat është vënë në mbrojtje. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

5. Deri në shpalljen e zonës së mbrojtur të monumenteve të kategorisë I, që ndodhen jashtë zonës së Qendrës Historike, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me nenin 32, të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, nuk lejohen ndërtime të reja në pronat kufitare me monumentin e kulturës. Trajtimi i objekteve ekzistuese kufitare të shqyrtohet në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve rast pas rasti.

Neni 9

Monumentet e kategorisë II

1. Monumentet e kategorisë II, janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si

formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekture, marrin pjesë në formulimin kompozicional të fshatit, por dhe ruajnë vlera arkitekture në vetvete.

2. Monumentet e kategorisë II ruhen në volumet e tyre fillestare dhe trajtimin e tyre arkitekturor të pamjes së jashtme dhe të brendshme në raste të veçanta, kur brenda këtyre monumenteve, sidomos në objektet e banimit, ruhen ambiente karakteristike, si gdhendje në dru, punime në allçi, dekorime pikturale ose mobilje arkitektonike me vlerë. Këto ruhen dhe i nënshtrohen restaurimit, duke përfshirë materialet dhe teknikat tradicionale.

3. Në brendësi të monumenteve të kategorisë II lejohen ndryshime të strukturës kompozicionale dhe përdorimin e teknikave bashkëkohore, pa cenuar formulimin e pamjes së jashtme, si dhe për t'u adaptuar edhe për shërbime të tjera.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Qendrën Historike të fshatit Dhërmi dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit.

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme kryhet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose prej subjekteve të licencuara për restaurim, nën mbikëqyrjen e supervisorit dhe kolaudatorit, caktuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Për monumentet e kulturës, pronë private, pjesa e shpenzimeve që i takon pronarit dhe mënyra e shlyerjes së tyre bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve të përmendura në shkronjat “c”, “d”, “e” dhe “f”, të pikës 2, të nenit 4, hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

4. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës ose nga subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në Zonën e Mbrojtur

1. Studimet për rehabilitimin e imazhit të Zonës së Mbrojtur hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Bashkinë Himarë ose subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve, sipas kësaj rregulloreje. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
2. Projektet e rikonstruksionit të ndërtesave në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
3. Zbatimi i punimeve të rikonstruksionit kryhet nga subjektet ndërtimore që janë të licencuara për këtë kategori.
4. Projektet për ndërtimet e reja në këtë zonë hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për fushën e ndërtimit. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.
5. Studimet dhe projektet për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore dhe rrjetin inxhinierik hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë, në bashkëpunim me Bashkinë e Himarës ose nga subjekte të licencuara në fushën restaurimeve dhe në kategoritë përkatëse të punimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit. Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”.

Neni 12

Zonat e gjelbëruara brenda Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur përreth saj

1. Zonat e gjelbëruara janë pjesë përbërëse e Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur, kanë destinacion publik dhe janë elemente që u shërbejnë pamjeve panoramike të Qendrës Historike. Hapësirat ekzistuese të gjelbëruara ruhen si të tilla.
2. Në këto zona lejohen ndërhyrje për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese si dhe mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e rrugicave të brendshme me karakteristika të njëjta, si të kalldrëmeve origjinale të Qendrës Historike, të cilat do të përdoren vetëm për këmbësorë.

3. Në këto zona janë të ndaluara ndërtimet me përjashtim të strukturave të elementëve të arredimit urban ose ato të shërbimit. Projektet për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara hartohen nga Bashkia Himarë ose nga subjekte të licensuara për këtë kategori punimesh.

4. Drurët dhe gjelbërimi tradicional i rrugëve dhe shesheve ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Neni 13

Shfrytëzimi i monumenteve

1. Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos çenojnë vlerat, për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

2. Shfrytëzimi i monumenteve të kulturës, për funksione të ndryshme prej atyre për të cilat janë ngritur, bëhet vetëm pasi të jetë marrë miratimi i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 14

Mbrojtja e monumenteve

1. Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritur në hapësirat e juridiksionit të tyre.

2. Plani i përgjithshëm vendor i Himarës detyrimisht merr parasysh vlerat e Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

Neni 16


Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003, "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 17
Dispozita të fundit

1. Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozimin e ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave.
2. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të zonifikimit të Qendrës Historike të fshatit Dhërmi dhe Zonës së Mbrojtur rreth saj.
3. Brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi e kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë i paraqet për shqyrtim dhe miratim ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës të kategorive I dhe II.

QENDRA HISTORIKE DHËRMI






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

MIRATOHET

KRYETARI I KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Z. EDI RAMA

MINISTRIA E KULTURËS



INSTITUTI I MONUMENTEVE
TË KULTURËS

DREJTOR

Znj. ARTA DOLLANI

Miratur me Vendim të KKR Nr. __, Datë __ / __ / __

LEGJENDË:

KLEFTI QINDORË HISTORIKI

KUFI I ZONËS SË MBROJTUR NËN ZONAT I

KUFI I ZONËS SË MBROJTUR NËN ZONAT II

MONUMENT KULTURE KATI

Z35

NR.PROT.6201/4
DATË 21.1.2016

MINISTRISË SË KULTURËS
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRIT TË SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME
PARLAMENTIN
INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



PËR SHPALLJEN QENDËR HISTORIKE TË DHËRMIUT, HIMARË
KORDINATAT GJEOGRAFIKE

Pika	Gjatësi			Gjerësi		
	gradë	minuta	sekonda	gradë	minuta	sekonda
QENDËR HISTORIKE 1						
1	40°	9`	8.87``N	19°	38`	7.77``E
2	40°	9`	10.51``N	19°	38`	8.63``E
3	40°	9`	11.94``N	19°	38`	8.52``E
4	40°	9`	12.94``N	19°	38`	8.94``E
5	40°	9`	14.00``N	19°	38`	9.04``E
6	40°	9`	14.57``N	19°	38`	8.43``E
7	40°	9`	16.05``N	19°	38`	10.53``E
8	40°	9`	17.16``N	19°	38`	10.54``E
9	40°	9`	18.47``N	19°	38`	14.48``E
10	40°	9`	18.79``N	19°	38`	16.67``E
11	40°	9`	18.03``N	19°	38`	17.70``E
12	40°	9`	16.67``N	19°	38`	17.73``E
13	40°	9`	15.88``N	19°	38`	18.46``E
14	40°	9`	14.59``N	19°	38`	18.46``E
15	40°	9`	13.30``N	19°	38`	17.25``E
16	40°	9`	11.88``N	19°	38`	15.78``E
17	40°	9`	11.85``N	19°	38`	14.42``E
18	40°	9`	11.24``N	19°	38`	14.05``E
19	40°	9`	10.18``N	19°	38`	12.54``E
20	40°	9`	9.06``N	19°	38`	11.63``E
21	40°	9`	8.14``N	19°	38`	10.37``E
22	40°	9`	7.84``N	19°	38`	9.16``E
QENDËR HISTORIKE 2						
1	40°	9`	17.49``N	19°	38`	21.54``E
2	40°	9`	18.32``N	19°	38`	24.94``E
3	40°	9`	17.51``N	19°	38`	27.44``E
4	40°	9`	16.76``N	19°	38`	29.21``E
5	40°	9`	14.93``N	19°	38`	30.96``E
6	40°	9`	13.15``N	19°	38`	32.12``E
7	40°	9`	12.86``N	19°	38`	34.12``E
8	40°	9`	11.79``N	19°	38`	35.98``E
9	40°	9`	10.18``N	19°	38`	35.34``E
10	40°	9`	9.81``N	19°	38`	34.63``E
11	40°	9`	7.10``N	19°	38`	34.36``E
12	40°	9`	5.88``N	19°	38`	33.68``E
13	40°	9`	6.42``N	19°	38`	29.45``E
14	40°	9`	6.42``N	19°	38`	29.45``E
15	40°	9`	6.95``N	19°	38`	28.02``E

16	40°	9`	4.74``N	19°	38`	27.42``E
17	40°	9`	2.89``N	19°	38`	24.72``E
18	40°	9`	2.19``N	19°	38`	23.40``E
19	40°	9`	3.06``N	19°	38`	19.20``E
20	40°	9`	3.90``N	19°	38`	17.48``E
21	40°	9`	5.00``N	19°	38`	15.95``E
22	40°	9`	6.33``N	19°	38`	16.03``E
23	40°	9`	7.59``N	19°	38`	16.53``E
24	40°	9`	8.70``N	19°	38`	18.25``E
25	40°	9`	10.09``N	19°	38`	19.33``E
26	40°	9`	11.29``N	19°	38`	20.35``E
27	40°	9`	11.93``N	19°	38`	21.46``E
28	40°	9`	11.95``N	19°	38`	22.63``E
29	40°	9`	13.07``N	19°	38`	23.24``E
30	40°	9`	13.69``N	19°	38`	22.51``E
31	40°	9`	14.95``N	19°	38`	22.42``E
32	40°	9`	16.03``N	19°	38`	22.64``E

ZONA E MBROJTUR DHËRMI						
1	40°	9`	9.02``N	19°	38`	5.91``E
2	40°	9`	9.85``N	19°	38`	6.64``E
3	40°	9`	11.51``N	19°	38`	7.07``E
4	40°	9`	13.11``N	19°	38`	7.01``E
5	40°	9`	14.33``N	19°	38`	6.68``E
6	40°	9`	14.71``N	19°	38`	8.16``E
7	40°	9`	15.98``N	19°	38`	9.44``E
8	40°	9`	16.42``N	19°	38`	9.61``E
9	40°	9`	17.15``N	19°	38`	9.43``E
10	40°	9`	17.40``N	19°	38`	10.20``E
11	40°	9`	18.28``N	19°	38`	11.57``E
12	40°	9`	19.17``N	19°	38`	13.64``E
13	40°	9`	20.26``N	19°	38`	16.50``E
14	40°	9`	21.74``N	19°	38`	20.81``E
15	40°	9`	21.21``N	19°	38`	24.07``E
16	40°	9`	18.30``N	19°	38`	26.71``E
17	40°	9`	17.51``N	19°	38`	28.98``E
18	40°	9`	15.91``N	19°	38`	31.03``E
19	40°	9`	13.84``N	19°	38`	32.63``E
20	40°	9`	13.34``N	19°	38`	34.18``E
21	40°	9`	11.94``N	19°	38`	36.52``E
22	40°	9`	10.12``N	19°	38`	37.05``E
23	40°	9`	8.27``N	19°	38`	37.05``E
24	40°	9`	7.22``N	19°	38`	41.37``E
25	40°	9`	7.61``N	19°	38`	43.45``E
26	40°	9`	6.65``N	19°	38`	43.94``E
27	40°	9`	6.41``N	19°	38`	44.73``E
28	40°	9`	5.15``N	19°	38`	44.04``E
29	40°	9`	3.98``N	19°	38`	43.65``E
30	40°	9`	1.97``N	19°	38`	42.51``E
31	40°	9`	0.56``N	19°	38`	42.95``E
32	40°	8`	58.15``N	19°	38`	43.24``E
33	40°	8`	57.14``N	19°	38`	44.27``E
34	40°	8`	54.07``N	19°	38`	42.12``E
35	40°	8`	49.73``N	19°	38`	37.04``E
36	40°	8`	50.12``N	19°	38`	35.75``E
37	40°	8`	47.41``N	19°	38`	31.25``E
38	40°	8`	44.41``N	19°	38`	26.20``E
39	40°	8`	45.96``N	19°	38`	22.13``E
40	40°	8`	48.85``N	19°	38`	17.63``E
41	40°	8`	49.30``N	19°	38`	17.90``E
42	40°	8`	50.55``N	19°	38`	17.46``E
43	40°	8`	53.56``N	19°	38`	20.15``E

44	40°	8`	54.15``N	19°	38`	19.74``E
45	40°	8`	53.97``N	19°	38`	17.41``E
46	40°	8`	55.50``N	19°	38`	15.97``E
47	40°	8`	57.83``N	19°	38`	15.71``E
48	40°	9`	0.17``N	19°	38`	15.80``E
49	40°	9`	1.81``N	19°	38`	14.89``E
50	40°	9`	3.64``N	19°	38`	13.65``E
51	40°	9`	5.47``N	19°	38`	13.88``E
52	40°	9`	7.13``N	19°	38`	14.64``E
53	40°	9`	7.87``N	19°	38`	13.92``E
54	40°	9`	7.83``N	19°	38`	10.06``E
55	40°	9`	7.35``N	19°	38`	9.21``E
56	40°	9`	7.97``N	19°	38`	7.34``E